

KËRKIMET PËR SME

Nje veshtrim ne “KËRKIMET për SMEs”

Objektivat:

Research for SMEs (Studim për NMV) mbështet grupe te vogla SMEs inovative ne zgjidhjen e problemeve teknologjike dhe ne thithjen e njohurive te reja teknologjike. Projektet duhet te përmbushin nevojat tregtare dhe inovative te SME-ve qe u është dhëne mundësia te nënkontraktojnë studimin tek studiues RTD (Research and Technological Development performers) me qellim thithjen e njohurive teknologjike te nevojshme. Projektet duhet te paraqesin qarte potencialin e shfrytëzimit dhe përfitimet ekonomike te SME-ve te përfshira.

Parime - Qasja e pergjithshme.

SME-t pjesëmarrëse janë përfituesit e drejtpërdrejte te projektit: ato investojnë ne një projekt RTD dhe nënkontraktojnë pjesën me te madhe te Aktivitetit Studimor dhe Aktivitetit Demonstrues tek studiuesit RTD, duke përfituar prej tyre njohuritë e nevojshme teknologjike për zhvillimin e produkteve te reja, sistemeve, proceseve ose shërbimeve apo për përmirësimin e atyre ekzistuese.

Ne kuadrin e këtij programi, marrëdhënia SME - studiues RTD është si marrëdhënia shitës - blerës. Ideja është zhvillimi i SME duke blere njohuritë teknike tek studiuesit RTD te cilët shesin punën dhe ekspertizën e tyre. Aktivitete studimore dhe zhvilluese qe kryhen vete nga SME, me burimet e tyre, përqendrohen kryesisht ne specifikime fillestare dhe me vone ne vlefshmërinë dhe testimin e njohurive te fituara. Ne ketë kontekst, investimi apo shpenzimi i bere nga SME eshte çmimi qe ato paguajnë për njohuritë teknike qe duan te marrin, te drejtat mbi to dhe mbi pronën intelektuale te lindur gjate projektit.

Për një vlerësim pozitiv te projekt-propozimit eshte e rëndesishme qe te jete qartesisht e shprehur dhe e justifikuar se si investimi studimor i propozuar përputhet me strategjine e pergjithshme finaciare te SME-se se perfshire. Edhe nëse masa e financimit publik është e madhe, ajo nuk mund te mbuloje te tere kostot, pjesa qe mbetet duhet te mbulohet nga vete subjektet pjesemarrrese. *Research for SMEs* nuk eshte nje instrument i pershtatshem per zgjidhjen e problemeve teknologjike afat-shkurtera, por ndihmon kompanite te fitojne njohurite e nevojshme teknologjike dhe te depertojne rrijetet nderkombetare, duke kontribuar ne zhvillimin e tyre afat-mesem dhe afat-gjate.

Eshte e rëndesishme te kihet parasysh qe *Research for SMEs* funksionon sipas skemes posht –lart: projektet mund ti referohen cdonjeres prej temave kerkimore te fushes se shkences dhe teknologjise..

Aktivitetet ne nje projekt.

Nje projekt-propozim duhet te perfsihje disa Aktivitete te ndryshme per te arritur objektivat :

- **(RTD)Aktivitete Studimi dhe Zhvillimi Teknologjik**, perbejne thelbin e projektit duke patur studiuesit RTD kontribues kryesor. SME-te perqendrohen ne
 - specifikimin, testimin e vlefshmerine e rezultateve te projektit dhe ne fazat pergatitore per shfrytezimin e metejshem.
- **(DEMO) Aktivitete Demonstrimi** jane parashikuar per te testuar qendrueshmerine e teknologjive te reja qe ofrojne perfitim te mundshem ekonomik por qe nuk mund te hidhen ne treg menjehere. Kjo eshte faza e fundit para se produkti apo procesi te futet ne prodhim.
- **(OTHER) Aktivitete te Tjera** ndihmojne SME-te ne perthithjen e rezultateve te projektit,ne veçanti për trajnimin dhe përhapjen e njohurive te fituara
- **(MANAG) Aktivitete Menaxhimi** jane pjese e rendesishme e projektit dhe ofrojne nje kuader te nevojshem per bashkimin e te gjitha pjeseve perberese te projektit dhe per mbajtjen e komunikimit te rregullt me Komisionin.

Kerkesa elementare per konsorcium

Projektet **Research for SMES** jane te hapura per pjesemarres nga keto kategori ::

- SME pjesmarrese: te pakten tre SME te pavarura, te vendosura ne tre Vende Anetare ose Vende te Asociuara.
- Studiues RTD: te pakten dy studiues RTD, prej cilitdo Vend dhe te pavarur nga pjesemarresit e tjere. Studiues RTD mund te jene universitete, organizata kërkimore apo kompani industriale, perfsihre SME kërkimore.

Subjekte te tjera apo konsumatore, gjithashtu mund te marrin pjese, duke dhene nje kontribut te caktuar ne projekt. Keto duhet te jene gjithashtu, te pavarur nga pjesemarresit e tjere.

Udhezime per burimet dhe kohezgjatjen.

Konsorciumi duhet te perbehet nga pese deri dhjete pjesemarres. Buxheti i pergjithshem i projektit duhet te jete 0.5 deri 1.5 milion Euro, ndersa kohezgjatja 1 deri 2 vjet. Nese nje projekt nuk perputhet me keto udhezime, kerkohet justifikimi i duhur.

Vendim-marrja, koordinimi i projektit dhe marrëveshja e konsorciumit

Qasja manaxheriale dhe vendim-marrese duhet te ndertohet duke pasur parasysh nevojat reale te SME-ve. Konsorciumi duhet te garantoje qe asnje vendim nuk do te merret ne kundërshtim me interesin e perbashket te SME-ve pjesëmarrëse.

Koordinimi i projektit eshte nje pune manaxheriale komplekse qe kerkon nje koordinator te kualifikuar dhe me pervojë. SME-te pjesemarrese mund t'ia besojne koordinimin e

projektit një studiuesi RTD apo një partneri në konsorciumi, i specializuar në menaxhimin profesional të projekteve.

Koordinatori kryen këto detyra:

- monitoron përmbushjen e detyrimeve nga ana e partnereve;
- verifikon nëse secili prej partnereve ka aksesin e caktuar në marrëveshjen e grantit
- merr kontributin financiar të Komunitetit dhe e ndan atë në përputhje me marrëveshjen e Grantit dhe të Konsorciumit –
- mban dokumentacionin dhe të dhënat financiare, informon Komunitetin për shpërndarjen e financave
- ndërmjetëson komunikimin korrekt ndërmjet pjesëmarrësve, si dhe raporton rregullisht për Komunitetin dhe pjesëmarrësve mbi ecurinë e projektit

Pasi një projekt të jetë përzgjedhur dhe të ketë përfunduar negociatat kontraktuale, pjesëmarrësit duhet të paraqesin një **Marreveshje Konsorciumi** të firmosur, për të detajuar akoma më tepër informacionin e dhënë në Shtojcën Teknike të Kontrates. Informacioni që do të kërkohej do të ketë të bëjë me organizimin e brendshëm të konsorciumit, menaxhimin e kontributit financiar të Komunitetit, menaxhimin e të drejtës mbi pronën intelektuale, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të brendshme.

Rregullat për Pronën Intelektuale

Që në fazën e propozimit, konsorciumi duhet të paraqesë një përshkrim të qartë e të detajuar të mënyrës se si do të ndahet pronësia mbi pronën intelektuale, mbi licencat, si dhe honoraret. Konsorciumi mund të vendosë të ndjehet mënyrën e paracaktuar nga Komuniteti, e cila i jep SME-ve pronësine e plotë të pronës intelektuale dhe rezultateve të projektit.

Megjithatë, konsorciumi mund të arrijë një marrëveshje për të vepruar ndryshe, përderisa SME-të kanë të garantuar të drejtat për përdorimin dhe shfrytëzimin e rezultateve të projektit. Një shembull është që studiuesit RTD të mbajnë pronësine e pronës intelektuale (ose vetëm një pjesë të caktuar), ndërsa SME të drejten mbi licencat.

Në këtë mënyrë studiuesit RTD bashkefinancojnë projektin me burimet e tyre. Si pasoje, çmimi dhe mënyrat e pagesës mes SME-ve dhe studiuesve RTD duhet të reflektojnë vlerën e pronës intelektuale dhe të njohurive teknike të fituara, psh çmimi i një licence duhet të jetë me i ulët se sa çmimi i pronësisë intelektuale.

Pergatitja e një propozimi

Kjo guide e shkurtër shërben për të kuptuar parimet se si funksionon **Research for SMEs** dhe nuk mund të zëvendësojë dokumentacionin zyrtar që lidhet me këtë Thirrje.

Për përgatitjen e propozimit duhet t'i referoheni :

- Programit të punës “Research for the benefit of SMEs”
- Udhezuesit për aplikuesit në “Research for SMEs”
- Udhezuesit për rregullat mbi pronën intelektuale për projektet FP7

- Rregullave për paraqitjen e propozimeve

Keto dokumenta, si dhe informacion i mëtejshëm për Thirrjet e hapura mund të gjenden në faqen e internetit:

http://cordis.europa.eu/fp7/dc/index.cfm?fuseaction=UserSite.CapacitiesDetailsCallPage&call_id=35.

Techweb i SME ofron një game të gjere informacioni për SME-te me profil teknologjik

<http://sme.cordis.lu/home/index.cfm>

*Ne cdo Vend Anetar apo Vend të Asociuar, **Rrjeti Kombëtar i pikave të kontaktit për SME** është institucioni përgjegjës për dhenien e udhëzimeve dhe asistencës së nevojshme dhe duhet të jetë kontakti i parë për paraqitjen e një projekt-propozimi.*

Informacion për Pikat Kombëtare të Kontaktit, për cdo vend gjendet në:

http://cordis.europa.eu/fp7/ncp_en.html

Perkufizimi i SME

Një SME që të quhet e tillë duhet të ketë më pak se 250 të punësuar, një xhiro vjetore që nuk i kalon 50 milion euro, dhe/ose një bilanc vjetor që nuk i kalon 43 milion euro. Gjithashtu mund të përdoren dhe kritere për sa i përket autonomisë. Me shumë informacion:

http://ec.europa.eu/enterprise/enterprise_policy/sme_definition/index_en.htm

Llogaritja e buxhetit të projektit.

Projekt-propozimet duhet të përfshijnë një plan të detajuar pune ku të paraqiten aktivitetet e nevojshme për arritjen e objektivave (të projektit.). Duke u bazuar në burimet që nevojiten për zbatimin e planit të punës, konsorciumi duhet të caktojë buxhetin e projekt-propozimit.

Hapi i parë : Buxheti për SME.

SME-te pjesëmarrëse mbulojnë kosto për Aktivitete të ndryshme të projektit. Pagesa e faturave të studiuësve RTD (pa TVSH) do të konsiderohet kosto e lejueshme për SME-te. TVSH nuk është kosto e lejueshme.

Shembulli hipotetik i mëposhtëm tregon një ndarje të mundshme të kostove sipas Aktiviteteve të ndryshme.

Buxheti për SME Aktivitete dhe Kosto	SME 1	SME 2	SME 3
RTD	260.000	395.000	125.000
te veta	45.000	55.000	20.000
Fatura për RTD të nen-kontraktuar	215.000	340.000	105.000
DEMO	10.000	25.000	0
te veta	10.000	20.000	0
Fatura për DEMO të nen-kontraktuar	0	5.000	0
Te Tjera	10.000	5.000	0

Menaxhimi	50.000	5.000	5.000
TOTALI	340.000	430.000	140.000

Hapi i dyte: Buxheti per studuesit RTD

Studiuesit RTD mbulojne kostot vetem per Aktivitete Menaxhuese dhe Aktivitetet te Tjera (përfshire trajnimin dhe përhapjen e njohurive).

Burimet qe perdoren per Aktivitete RTD dhe Aktivitete Demonstrimi do t'i faturohen direkt SME-ve pjesmarrrese sipas nje çmimi te pranuar me pare dhe reflektohen ne buxhetin per SME-te.

Buxheti per studuesit RTD Aktivitete dhe Kosto	RTD 1	RTD 2
Te Tjera	0	30.000
Menaxhimi	5.000	5.000
TOTALI	5.000	35.000

Hapi i trete: Buxheti për Subjekte te Tjera dhe Konsumatore.

Ne disa raste, SME-te pjesemarrrese kerkojne edhe pjesemarrjen e subjekteve te Tjera dhe/apo konsumatoreve (OTH) per te dhene nje kontribut te caktuar ne projekt. Edhe keto mund te mbulonje kosto për Aktivitete te ndryshme te projektit.

Buxheti per Subjekte te Tjera dhe Konsumatore Aktivitetet dhe Kosto	OTH 1
RTD	10.000
DEMO	40.000
Te Tjera	0
Menaxhimi	5.000
TOTALI	5.000

Hapi i katert: Buxheti total i projektit

Buxhetet e veçanta formojne buxhetin total te projekt-propozimit

Partnere dhe Kosto	RTD	DEMO	MANAG	TE TJERA	TOTAL
SME 1	260.000	10.000	60.000	10.000	340.000
Aktivitete te veta	45.000	10.000	125.000		
Nen-kontraktme	215.000		20.000		

SME 2	395.000	25.000	5.000	5.000	430.000
Aktivitete te veta	55.000	20.000			
Nen-kontraktme	340.000	5.000			
SME 3	125.000	0	5.000	10.000	140.000
Aktivitete te veta	20.000				
Nen-kontraktme	105.000				
RTD 1			5.000	0	5.000
RTD 2			5.000	30.000	35.000
OTH 1	10.000	40.000	0	0	50.000
TOTAL	790.000	75.000	80.000	55.000	1.000.000

Llogaritja e kontributit te Komunitetit Evropian

Komuniteti European garanton financim vetem per nje pjese te caktuar te koston totale te projektit. Prandaj, SME-te pjesemarrese do te duhet te kontribuojnë vete ne projekt, me burimet e tyre, ne cash apo in-kind. Kontributi i KE bazohet ne financime limite (tavan) sipas Aktiviteteve te ndryshme:

- Aktivitete studimi dhe zhvillimi teknologjik: maksimumi i financimit 50 % te koston se pranuar.
Megjithate, per SME-te, per organizata jo-fitimprures, per institucione arsimore te mesme dhe te larta, per organizata kerkimore mund te arrihet financim deri ne masen 75 %
- Aktivitete Demonstruese: maksimumi i financimit 50%
- Aktivitete Menaxhimi ose Aktivitete te Tjera: financim deri ne masen 100%

Nje rregull i rendesishem per llogaritjen e kontributit te KE :

Me qellim arritjen e synimit per te promovuar nenkontraktimin e Aktiviteteve Studimore dhe Aktiviteteve Demonstruese, mbeshtetja financiare per projektin do te arrije (do te jete) 110% te shumës totale qe u eshte nënkontraktuar studiuvesve RTD (shuma do t'i faturohet SME-ve nga studiuvesit RTD)

Partnere dhe Kosto	RTD (50% - 70%)	DEMO (50%)	MANAG (100%)	TE TJERA (100%)	TOTAL	Kontribut max i KE
SME 1	260.000	10.000	60.000	10.000	340.000	270.000
Aktivitete te veta	45.000	10.000	125.000			
Nen-kontraktme	215.000		20.000			
SME 2	395.000	25.000	5.000	5.000	430.000	318.750
Aktivitete te veta	55.000	20.000				

Nen-kontraktive	340.000	5.000				
SME 3	125.000	0	5.000	10.000	140.000	108.750
Aktivite te veta	20.000					
Nen-kontraktive	105.000					
RTD 1			5.000	0	5.000	5.000
RTD 2			5.000	30.000	35.000	35.000
OTH 1	10.000	40.000	0	0	50.000	25.000
TOTAL	790.000	75.000	80.000	55.000	1.000.000	762.500
Totali i nenkontraktimit,pa TVSH						665.000
Kontributi maksimal i KE = 110% i nenkontraktimit te RTD,pa TVSH						731.500
Kontributi i kërkuar nga KE eshte minimumi						731.000

Pra, ky projekt shembull do te marre nje financim prej 731.000 euro.

Shperndarja e kontributit te Komunitetit Evropian

Partneret ne konsorcium duhet te vendosin se si do ta ndajne mes tyre kontributin e KE. Eshte e rëndesishme te dallohet ndarja e kostove per çdo partner nga ndarja e kontributit te KE mes tyre. I takon konsorciumit te vendose per kete. Kjo i jep mundesi konsorciumit te gjeje balancen e duhur per kontributin ne projekt te çdo partneri dhe per perfitimet e pritshme nga rezultatet e projektit.

Per projektin-shembullin tregohen 2 skenare te mundshem - por duhet patur parasysh qe çdo konsorcium duhet te beje ndarjen sipas mundesive te pjesemarrësve te vet.

Eshte e rëndesishme mos te harrohet se SME-te do te duhet te llogarisin pagesen e faturave te studiuësve RTD. Çdo pjesemarrës, gjithashtu duhet te garantoje kryerjen e transaksioneve dhe pagesave ne perputhje me ligjet kombetare.

Skenari 1: Studiuësit RTD marrin nje kontribut te caktuar per te mbuluar Aktivitetet Menaxhuese dhe Aktivite te Tjera.

SME 2 dhe SME 3 marrin nje kontribut qe i lejon ato te mbulojne faturat e studiuësve RTD dhe pjesa e mbetur e kontributit te KE-se i shkon SME 1. Pjesemarrësi OTH1 nuk perfiton nga kontributi i KE-se.

Partnere dhe Kosto	Kosto totale	Kontributi i KE per çdo pjesmarres	Kontribut i veti (in-kind)	Kontribut i vet (in cash)
SME 1	340.000	241.500	98.500	0
Nen-kontrakttime	215.000			
SME 2	430.000	345.000	85.000	0
Nen-kontrakttime	345.000			
SME 3	140.000	105.000	35.000	0
Nen-kontrakttime	105.000			
RTD 1	5.000	5.000	0	0
RTD 2	35.000	35.000	0	0
OTH 1	50.000	0	50.000	0
TOTAL	1.000.000	731.500		

Skenari 2: Secili partner perfiton financim nga KE ne baze te pjeses se tij te koston ne projekt, me perjashtim te pjesmarresit OTH1, i cili nuk perfiton nga Kontributi i KE-se

Partnere dhe Kosto	Kosto totale	Kontributi i KE per cdo pjesmarres	Kontribut i veti (in-kind)	Kontribut i vet SME (in cash)
SME 1	340.000	261.800	78.200	0
Nen-kontrakttime	215.000			
SME 2	430.000	331.100	98.900	13.900
Nen-kontrakttime	345.000			
SME 3	140.000	107.800	32.200	0
Nen-kontrakttime	105.000			
RTD 1	5.000	3.850	1.150	0
RTD 2	35.000	26.950	8.050	0
OTH 1	50.000	0	50.000	0
TOTAL	1.000.000	731.500		